VENDIM
Nr. 52, datë 31.1.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 564, DATË 31.7.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR MBROJTJEN E VEÇANTË TË MAGJISTRATIT GJATË USHTRIMIT TË FUNKSIONIT OSE PËR SHKAK TË TIJ"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 20, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 564, datë 31.7.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"17. Subjektet e përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të masave të mbrojtjes, mund të paraqesin para komisionit kërkesë për zgjatjen e këtij afati. Komisioni mund të vendosë zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes kur rrethanat, për të cilat është siguruar më parë mbrojtja, vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të këtij afati ose kur ka të dhëna të tjera të besueshme që provojnë se magjistratit i rrezikohen jeta, familja apo pasuria.".

b) Pas pikës 17 shtohen pikat 17/1 dhe 17/2, me këtë përmbajtje:

"17/1. Komisioni, edhe kryesisht, pas një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e masave të mbrojtjes, si dhe sa herë të konsiderohet e nevojshme, përpara përfundimit të afatit të mbrojtjes, bën verifikimin e kushteve për të përfituar mbrojtje të veçantë dhe të nevojave të sigurimit. Në përfundim të verifikimit, Komisioni merr vendim për zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes, shtimin ose pakësimin e tyre apo ndërprerjen e mbrojtjes së veçantë.

17/2. Gjatë afatit, brenda të cilit sigurohet mbrojtja e veçantë, magjistrati, magjistrati që nuk e ushtron funksionin ose magjistrati që ka dalë në pension, si dhe familjarët e tij, janë të detyruar që:

a) të bashkëpunojnë në mënyrë aktive për zbatimin e vendimit të Komisionit;

b) të mënjanojnë çdo veprim ose mosveprim, që mund të rrezikojë zbatimin e mbrojtjes së veçantë apo që mund të sjellë, si pasojë, një gjendje tjetër rreziku për ta ose për jetën dhe shëndetin e shoqëruesve personalë;

c) të informojnë menjëherë Komisionin për çështje që kërkohen prej tij ose për ngjarje apo ndryshime të rrethanave të jetës a veprimtarive të tij personale, si dhe për kontaktet e marrëdhëniet me të tretë, që mund të rrezikojnë zbatimin e mbrojtjes së veçantë;

ç) të pranojnë, nëse është e domosdoshme për qëllimet e mbrojtjes, përdorimin në mjediset e veta të mjeteve teknike të ruajtjes, vëzhgimit dhe regjistrimit pamor dhe/ose zanor.".

2. Ngarkohen ministri i Drejtësisë, ministri i Brendshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama